



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 30.10.2012, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, këshilltarët: Engin Beyoglu, zv. kryesues i Kuvendit të Komunës për komunitete, Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kosumi, Hetem Kupina, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Avdush Dobratiqi, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Fetah Salihu Vjollca Rizani, , Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Remzi Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Valon Hiseni, Shemi Veseli, Besa Halimi – Zagragja, Lumnie Rama, Liridon Restelica, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Feti Mejdiu, Kimet Zeqa, Sadri Ramabaja dhe Afërdita Veliu.

Munguan: Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, Ajnishahe Azemi dhe Skënder Reçica.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE – së, të shoqërisë civile dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Engin Beyoglu**, zv. kryesues i Kuvendit të Komunës për komunitete, i cili fillimisht tha se pika e gjashtë e rendit të ditës, *Propozimvendimi për vazhdimin e dhënies së pronës komunale në shfrytëzim me qira*, pas sugjerimeve dhe kërkesave të anëtarëve të KPF-së, dhe pas konsultimit me Kryetarin e Komunës, kemi vendosur që, për hir të riverifikimit të këtyre pronave, kjo të shtyhet për shqyrtim në njërin nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

Liridon Restelica tha se paraprakisht znj. Afërdita Veliu është dashtë që për këtë vendim që ka marr, diskutimin ta bëjë së pari me organet e PDK-së, por ai është vendim personal i saj dhe ne i dëshirojmë sukses në punën e saj të mëtutjeshme.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, i uroi mirëseardhje znj. Veliu në grupin e Vetëvendosjes, duke thënë se kjo është një dëshmi që Vetëvendosje është formacion i ri politik dhe i hapur për të gjithë ata që reflektojnë shqiptarisht.

Me ndryshimin që pika e gjashtë të hiqet nga rendi i ditës, u konstatua se njëzëri u miratua ky

R E N D D I T E :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit;**
- 2. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit;**
- 3. Informatë për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës për vitin shkollor 2011/2012;**
- 4. Informatë për shpenzimet dhe të hyrat për periudhën janar-shtator 2012;**
- 5. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);**
- 6. Propozimvendimi për lejimin e mjeteve në shumë prej 100.000,00 €, si ndihmë për punëtorët e organeve të administratës, të institucioneve kulturore dhe qendrave për punë sociale të Komunës së Prishtinës;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**
- 8. Të ndryshme.**

Pika e parë

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit.

Pika e dytë

Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit

Ismail Kasumi bëri betimin para Kuvendit të Komunës.

Pika e tretë

Lidhur me Informatën për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës për vitin shkollor 2011/2012, në pika të shkurtra informoi Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, i cili tha se në këtë informatë është paraqitur sukcesi i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme të

Komunës së Prishtinës. Përveç kësaj, janë paraqitur edhe sfidat dhe problemet të cilat ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies etj.

Vjollca Dibra - Ibrahim tha se kjo informatë është shqyrtuar edhe në Komitetin për arsim dhe kulturë, ku të gjithë u pajtuam, së bashku me drejtorin, se Drejtoria e Arsimit në këtë kohë ka sfida të pareshtura, në mënyrë që të bëjë diçka në përmirësimin e cilësisë së arsimit nëpër shkolla. Ajo që është shumë e rëndësishme dhe që është cekur këtu edhe nga Drejtoria e Arsimit, është se mungon mbikëqyrja pedagogjike dhe profesionale, një mbikëqyrje që megjithatë do të jetë më se e domosdoshme për të ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e procesit arsimor. Ajo që është konstatuar edhe në Komitetin për arsim e kulturë, të gjithë së bashku u morëm vesh që duhet të formohet një ekip, i cili do të fillonte nga Inspektorati i Ministrisë së Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit, që do të bënte një inspektim sa më të shpejtë në disa shkolla, në të cilat shihet se raportet e dorëzuara në drejtori pak a shumë nuk përkojnë me realitetin. Ka shumë probleme të tjera, si problemi i pushimit mjekësor, i pushimit të lehonisë, e që ndikojnë në mbarëvajtjen e mësimin.

Aziz Pacolli e vlerësoi këtë informatë shumë profesionale, të kompletuar, por duke marrë parasysh atë që e tha edhe drejtori si thelbi i arsyes së ngecjes në arsim. Nuk është vetëm arsyeja e ngecjes te paga ajo pse stagnon arsimi, por ndoshta është edhe te ndërgjegjja e vet punëtorëve të arsimit, dhe sot e kemi punën e punëtorëve të arsimit çfarë e kemi. Në të ardhmen ky problem të jetë edhe i shkruar, siç është edhe informata për nxënës, për suksesin e nxënësve, pra të jetë edhe një informatë e shkruar me shkrim rreth punës dhe përgjegjësisë të punëtorëve të arsimit. Që të kemi shërbime më cilësore në arsimin e Prishtinës, duhet të kemi vlerësim në punën e mësimdhënësve, të kemi një kontroll në realizimin e planprogrameve mësimore dhe në fund të vitit, përveç suksesit të nxënësve, të kemi edhe vlerësimin mbi realizimin e planprogrameve nga mësimdhënësit. Kjo është më se e nevojshme që të ngrihet niveli dhe cilësia në arsim.

Besa Halimi- Zagragja fillimisht ngriti një shqetësim rreth çështjes së mungesës së vazhdueshme të disa anëtarëve të Komitetit për arsim. Për informatën tha se e bëme analizën e kësaj, si atë tabelore dhe të shkruar, dhe kam disa çështje për të diskutuar në lidhje me të dhënat që janë paraqitur.

Dihet se në çdo shkollë ka organe qeverisëse dhe organe profesionale. Të gjitha ato e kanë përshkrimin e detyrave të tyre, për të cilat raportojnë. Ato analiza shkojnë te drejtori, drejtori raporton në Drejtorinë komunale në takimet e drejtorëve dhe mund të bëhet një mbikëqyrje, një analizë. Nuk është se mungojnë krejtësisht mekanizmat për mbikëqyrjen qoftë të mbarëvajtjes, qoftë të cilësisë, qoftë të shkaqeve të tjera të prishjes së rendit, por duhet që të gjithë këta mekanizma të funksionalizohen më tepër, të shtohet llogaridhënia. Të dhënat në tabelë, nuk janë krahasuar me një tabelë tjetër të vitit paraprak. Të dhënat në përshkrimin me shkrim në informatë, janë krahasuar pjesërisht vetëm në dy të dhëna, në atë të suksesit dhe të orëve të mbajtura. Në fakt, në informatën e

arsimit në njëfarë mënyre, është bërë vetëm përshkrimi i tabelës, dhe nuk është bërë ndonjë interpretim pak më kritik i asaj që është në tabelë. Ka mungesë të të dhënave të vlefshme, siç është ajo për disiplinën, mungon arsyetimi për orët e pa mbajtura etj. Gjithashtu mesatarja e nxënësve në klasa del shumë e mirë, del një mesatare kështu reale. Ishte dashur të thuhet se në viset rurale kjo mesatare është vërtetë tepër e vogël, sepse në shkollat e qytetit është shumë më e madhe. Kjo informatë do të duhej të ishte pak më e qartë dhe pak më e analizuar në mendim kritik.

Afërdita Veliu tha se edhe në Vetëvendosje e kemi diskutuar dhe e kemi analizuar këtë informatë, dhe kemi vërejtur se rezultati i pasqyruar në këtë informatë nuk është në përputhje me realitetin, respektivisht është e fryrë nga drejtoritë. Por, ajo çka më së shumti na shqetëson neve është rënia e cilësisë në arsimin fillor dhe atë të mesëm, të cilën pjesërisht drejtoria edhe e ka pranuar. Përgjegjësi në këtë masë kanë të dy nivelet e arsimit, Ministria e Arsimit dhe Drejtoria e Arsimit në kuadër të Komunës.

Sadri Ramabaja mbështeti vërejtjet që dhanë parafolësit, por ai potencoi se në informatën plotësuese janë dhënë disa shpjegime mbi atë se pse e kemi këtë gjendje që e kemi në arsim. Janë 5-6 shpjegime shumë specifike, ta zëmë numri i madh i nxënësve nëpër shkolla, diku hapësira shkollore, që ka implikuar pastaj çështjen financiare, numri i madh i mungesave të pa arsyeshme, mungesa e një shërbimi profesional, infrastruktura shkollore e nivelit jo të kënaqshëm etj. etj. Të gjitha këto qëndrojnë, por nuk është potencuar fakti kryesor, pse kjo gjendje në arsimin fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë?!

Ne gjykojmë se njëra prej arsyeve kryesore është trajtimi jo me prioritet i arsimit në rrafshin politik, politizimi ekstrem i udhëheqjeve nëpër shkolla. Arsye tjetër që ndërlikohet me këtë fakt është edhe punësimi i kuadrit të pakualifikuar, sidomos në shkollat në zonat rurale. Në raport do të duhej përshkruar në mënyrë më të detajuar edhe fati i nxënësve, respektivisht programet e shkollave në mësimin privat. Njëherë e kam potencuar se në një pjesë, së paku të arsimit privat, nuk respektohet Planprogrami i Republikës së Kosovës, si veprohet në ato shkolla etj.

U theksua edhe fakti i implikimit të çështjeve financiare me shtimin e hapësirave shkollore etj., por nuk u tha një fakt që te ndarja e buxhetit, përgjegjësi i Komunës, respektivisht ai që ka marrë pjesë në ndarjen e këtij buxheti, nuk ka qenë në nivelin e përgjegjësisë as politike, as profesionale.

Shefqet Sylejmani tha se kjo është informatë, nuk është raport, prandaj si të tillë do ta pranojmë, ku konkretisht disa vërejtje dhe sugjerime do t'i paraqes znj. Mejreme Berisha.

Mejreme Berisha tha se kjo është një temë shumë e ndjeshme dhe shumë problematike, ku sfidat dhe problemet janë të mëdha dhe të shumta. Shumë më brengosës në komunën tonë është numri i madh i nxënësve në paralele, pastaj mungesat e shumta, braktisja e shkollës nga një numër i nxënësve nëpër fshatra pa e kryer as vitin e nëntë etj. Kisha pasur dëshirë që të punohet më shumë në

këtë drejtim nga Drejtoria e Arsimit. Problem tjetër është fryrja e suksesit, çështja e ekskursioneve, gjegjësisht forma se si po organizohen është e papëlqyeshme për mua, sepse nuk po vizitohen vendet më të rëndësishme historike, andaj kërkoj që këto organizime të bëhen pak më mirë. Problem tjetër për ne mësimdhënësit është se shumë shkolla në Prishtinë, shkolla të mesme, sidomos shkollat profesionale, po mbesin pa nxënës. Duhet ta gjejmë një rrugë, në mënyrë që ato shkolla të mos mbesin ashtu, në mënyrë që të mos fryhet numri i nxënësve në shkollat tjera, sidomos në gjimnaze, jo vetëm në afatin e parë, por edhe në afatin e dytë.

Feti Mehdiu, në emër të Grupit parlamentar të Partisë së Drejtësisë, tha se Informata, me gjithë ato vërejtje, ka pasur mundësi të jetë më e plotë. Si informatë ne do të duhej ta kishim më të qartë, nuk na takon të gjithë neve, por ky sukses që e përmendi edhe znj. Berisha, sukcesi shumë i mirë ose i shkëlqyeshëm në maturë, kurse kur hyjnë në provim për universitet, nuk mund ta japin me dy herë, ose duhet bërë riprovim, që nuk ju ka hije këtyre masave kualifikuese të universitetit, pra nuk e kemi real suksesin. Një prej problemeve është edhe numri i madh i nxënësve etj. Një nga shkaqet që kanë ndikuar janë edhe urdhëresat administrative gjithkund ku janë paraqitur, vetëm i kanë ngatërruar punët, nuk i kanë zgjedhur, i kanë ngatërruar më shumë, prandaj po them me urdhëresa nuk duhet të punohet. Do të duhej që sa më shpejt të riaktivizohet inspektorati. Tjetra, që mund të jetë edhe përzjerje kompetencash, dhe unë mendoj se inspektori ka tjetër funksion, këshilltari ka tjetër. Puna e Ligjit që i përkufizon disa çështje në lëmin e arsimit, konkretisht problemet shëndetësore, ato nuk janë në kompetencë të Komunës së Prishtinës. Mendoj që Ligji duhet të korrigjohet, të filloj procedura për ndërrimin e tij. Këtë të metë të Ligjit ne nuk mund ta përmirësojmë, por ne mund ta iniciojmë. Mendoj kjo vërejtje duhet të përcillet tutje, sepse ligjet kur bëhen me nguti edhe reformat na japin këto rezultate.

Shefki Gashi fillimisht bëri pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, se a ka mundur të hiqet nga shkollat sakrificat e arsimtarëve dhe patriotizmi dhe a ka mundur të arrihet ajo se ne jemi viktimë, se nuk po paguhemi, nuk kemi rroga, nuk kemi para, ne kemi rroga të vogla, si dhe disa çështje të tjera që ndikojnë në mbarëvajtjen e rregullt të mësimin, pra kjo laramani a ka mundur të eliminohet prej shkollave. Nxënësin duhet mësuar, duhet dhënë edukatë dhe duhet vlerësuar drejt. Ky lloj sindrome ka filluar edhe në administratë, edhe te punëtorët e Komunës, se ne nuk kemi rroga, andaj duhet të kryhen punët pa patriotizëm, pa ndjenja patriotike, pa sakrificë, por sipas planprogramit që është. Është planprogrami apo nuk është, për atë janë ekspertët, është Ministria, janë punët tjera.

Astrit Hasani kërkoi që të ketë më shumë bashkëpunim mes shkollave të Kosovës dhe shkollave të vendeve tjera, ku do të ketë edhe binjakëzime mes këtyre shkollave, dhe do të mund të organizohen edhe vizita studimore dhe do të përfitohen përvoja të ndryshme.

Për vërejtjet, shqetësimet dhe sugjerimet e paraqitura nga parafolësit, informata shtesë dha **Halim Halimi**.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës për vitin shkollor 2011/2012.

Pika e katërt

Lidhur me Informatën për shpenzimet dhe të hyrat për periudhën janar-shtator 2012, në pika të shkurtra informoi Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me këtë pikë.

Tefik Mehmeti, në emër të GP të LDK-së, tha se kjo informatë mbi rrjedhën e të hyrave dhe shpenzimeve për nëntëmujorin e vitit 2012, është e mjaftueshme dhe na jep një pasqyrë të nevojshme, të plotë, rreth gjendjes financiare të Komunës së Prishtinës, se si kanë rrjedhë të hyrat sipas planifikimeve dhe si janë realizuar e shpenzuar. Vërejmë se të hyrat janë në nivel të planifikimeve, përpos disa rasteve që besoj se sqarimet që janë dhënë, janë të mjaftueshme dhe nuk kemi nevojë t'i përsërisim. Shpenzimet janë në suaza normale, ndoshta tek investimet kapitale vërehet që është një përqindje më e ultë e shpenzimeve, por e kemi cekur edhe më parë se shumica e punëve të mëdha përfundojnë apo teknikisht pranohen në tremujorin e fundit të vitit. Kjo është praktikë në të gjithë Kosovën, ashtu që edhe shpenzimet më të mëdha të investimeve kapitale bëhen në këtë periudhë, pra në periudhën e fundit të vitit.

Besojmë që edhe kjo kategori e shpenzimeve deri në fund të vitit, do të arrijë në kuotat e planifikimit.

Si GP e përkrahim këtë informatë.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se këtë informatë e kemi shqyrtuar dhe analizuar. Kjo është një informatë e plotë, por i kemi disa vërejtje apo pyetje lidhur me të hyrat vetanake, aty ku thuhet "*të hyra të tjera*". Të hyra të tjera, nëse llogariten në përqindje, janë 135.79%, cilat janë ato të hyra të tjera që e kanë arritur këtë nivel të përqindjes kështu?. Se vërtet qenkan të hyra, të cilat meritojnë që edhe në të ardhmen të kemi një rritje të të hyrave të tjera. Është një kërkesë tjetër, të shpenzimet komunale, edhe në KPF kemi kërkuar që të zërthehen pak këto shpenzime komunale, dhe ka qenë një vërejtje prej të gjithëve, apo një brengosje prej të gjithë anëtarëve të KPF-së, investimet kapitale deri në këtë periudhë janë 26.88%, pra është një përqindje shumë e vogël që e llogarisim ne si përqindje.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, tha se si profesionist i këtij lëmi fillimisht të të hyrat vetanake, qysh në miratimin e buxhetit të këtij viti, i kam dhënë disa sugjerime dhe disa versione, me të cilat ky buxhet ka mundur të jetë shumë më i madh dhe këto të hyra kanë mundur të jenë shumë më të larta, por

duke e pasur parasysh që aftësitë menaxhuese janë në nivel shumë të dobët, në aspektin e menaxhimit të këtij sektori, është një dështim shumë i madh. Desha të lidhem më shumë të shpenzimet buxhetore. Realizimi i projekteve kapitale nuk bëhet në afatin e paraparë, andaj neve si Komunë e Prishtinës, në këtë rast na mbyllen dyert për të kërkuar subvencione ose financa tjera për projekte shtesë kapitale për Komunën e Prishtinës, sepse në këtë rast Komuna nuk është në gjendje t'i shpenzojë këto çka i ka. Thuhet që një pjesë e konsiderueshme e projekteve gjenden në fazën përfundimtare, andaj dua të dijë se cilat janë ato projekte, sa është vlera, përqindja e atyre projekteve të cilat janë realizuar, ose që janë duke u realizuar etj.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, shprehu qëndrimin se kjo informatë përpos që është mirë që na është dhënë në këtë kohë, është reale dhe objektive.

Edhe numrat që i kemi para vetes, janë numra që përkojnë me afatin e të hyrave dhe shpenzimeve në Komunën e Prishtinës. E vërteta është që në disa segmente të të hyrave kemi pak çalime, mirëpo aty janë arsyet e konsiderueshme. Edhe ky Kuvend do të duhej ta kishte në konsideratë këtë çështje, p.sh. te prona, te tatimi, ne duhet ta dimë se aty kemi probleme me këtë popullatë, se popullata për ditë e më tepër varfërohet, prandaj mund të ketë ngecje në këtë drejtim, pastaj te gjobat në trafik etj. Mendoj që duhet të jemi të kujdesshëm për këto çështje kur i japim këto vlerësime.

Te shpenzimet kapitale, ne e konsiderojmë shumë të rëndësishëm me problemet me të cilat ballafaqohet ky segment i jetës dhe veprimtari tonë, ngase kemi probleme, sepse paradhënie më nuk mund të jepen, por vetëm kur të përfundojë puna, atëherë mund të paguhet, dhe konsideroj që këtu është ajo ngecje në shikim tonë, përndryshe nuk është ngecje reale. Gjithashtu mosrealizimi i projekteve me kohë lidhet edhe me problemin e prokurimit. Për ta dhënë realisht dhe objektivisht vlerësimin e kësaj informate, duhet t'i kemi parasysh këto fakte. Duke i pasur parasysh të gjitha këto, ne si GP e mbështesim këtë informatë edhe pajtohemi me te.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se kjo informatë do të duhej t'i kishte edhe disa detaje më shumë, si p.sh. sa projekte janë në zhvillim e sipër në përfundim etj., por këto janë çështje të ekzekutivit. Kërkoj nga drejtorët që të tregohen më dinamik në punë. Një gjë po e dimë të gjithë dhe asnjëri nuk po e themi; Ligji i prokurimit është pengesa më e madhe, që e dimë të gjithë se është i obliguar me ia dhënë projektin atij që është më i liri, e ai më i liri nuk bënë kurrgjë, e zvarrit punën, projekti nuk kryhet si duhet dhe me kohë.

Këto gjëra duhet në kohë të rregullohen, prandaj duhet diçka të bëhet në këtë drejtim; nuk po e them që t'iu merren licencat kompanive, siç janë nja 4-5 kompani që e fundosën Komunën. Duke pasur parasysh këto çështje, duhet të bëhet një ndryshim në këtë drejtim, konkretisht te Zyra e prokurimit.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se nga këto që i thanë kolegët paraprakisht, përgjegjësit për këtë informatë dhe për këto shpenzime dhe

këto kursime, do t'i kenë parasysh që vepronjë ashtu siç është e mundur më mirë. Unë do të ndalem në faqen e dytë, me udhëzimin administrativ, po shihet aty sa është paraparë, sa do të gjobisim për ta rritur buxhetin, që nuk më duket fortë e logjikshme ajo gjë. Por, ajo tjetra çka vlen të theksohet, urdhëresat administrative nganjëherë po e komplikojnë ligjin, konkretisht në disa fusha. Në këto gjëra mendoj që duhet të jemi më tepër të kujdesshëm, më tepër të jemi të vetëdijshëm. Nuk është me rëndësi sa plotësohet, apo nuk plotësohet buxheti. Kjo më duket se është mirë, mund të rregullohet ndryshe ajo, se kur figuron është planifikuar prej të hyrave nga gjobat, më duke si jo e kapshme. Me ato sugjerimet që i dhanë kolegët paraprakisht, do ta përkrahim këtë informatë.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, u shpreh se kësaj informate i mungon shumëçka për të qenë informatë. Në këtë informatë nuk janë pasqyruar të gjitha shpenzimet buxhetore që janë bërë brenda kësaj periudhe, e që është dashtë të pasqyrohen edhe ato. Na vjen një informatë që paraqet pozicionin e shpenzimeve prej diku 45% të buxhetit, në kohën kur kanë mbetur vetëm edhe 3 muaj deri në fund të vitit, dhe nëse fryhet për qind, për qind, prapë deficitit është i paralajmëruar qysh tash. Madje, sipas informatave që ka LV, deficitit në këtë Komunë do të jetë më i madh sesa vitin e kaluar. Ku janë shpenzimet reale të Komunës për zërat tjerë që na mungojnë në këtë informatë, si për naftë, telefona, dreka, darka, etj., që fshihen në mënyrë tepër të përgjithësuar.

Analiza që është publikuar nga GAP-i, flet relativisht zi për pozicionin e Komunës së Prishtinës në këtë rrafsh. Prandaj, uroj që raporti të jetë më në përputhje me shpenzimet reale dhe më i saktë, sepse po detyrohemi prapë të marrim informata nga burimet tjera.

Mustafë Krasniqi tha se Kryetari në mënyrën më të mirë më të mundshme, po i kryen punët që i ka si Kryetar i Komunës së Prishtinës. Sa i përket informatës, mendoj që kjo është vetëm një informatë, pra nuk është ndonjë raport i plotë për pasqyrimin e të gjitha të dhënave që u kërkuan.

Avdullah Hoti i falënderoi të gjithë ata që dhanë komente dhe sugjerime, duke thënë se disa prej tyre vërtet ishin konstruktive, në funksion të rritjes së performancës së shpenzimit të parasë publike në Komunën e Prishtinës. Këtë informatë e kemi dhënë plotësisht në përputhje me ligjin në fuqi për raportim financiar, ashtu si kërkohet çdo tre muaj. Është raporti gjashtëmuajor që i ka pas detajet për të gjitha projektet brenda Komunës.

Ajo që po tentohet me u thanë është që, në fakt po qitet në lajthitje ky Kuvend komunal dhe qytetarët, sepse shfrytëzimi i parasë në komunën e Prishtinës e ka performancën më të mirë jo në këtë vit, por prej vitit 2008, prej se kryetari z. Isa Mustafa, është në krye të Komunës. Të gjitha projektet që janë të miratuar në këtë Kuvend komunal në buxhetin e vitit 2012, të gjitha janë të kontraktuara, dhe se ky raport është për shpenzime sa kanë arritur deri tash. Në bazë të dinamikës, shumica e shpenzimeve në të gjitha institucionet kryhen, përmbillen përfundohen në tremujorin e tretë.

Shemsi Veseli e përkrahu formën e informatave që ka filluar kryetari t'i japë, edhe pse më herët kanë munguar këto dhe ka qenë një obligim ligjor, i cili e ka obliguar kryetarin për çdo tre muaj dhe tash po shihet se ka filluar edhe gjashtëmujori dhe nëntëmujori. Në bazë të kësaj që është shkruar, ne nuk mund të imagjinojmë as shifra të tjera, as ta zvogëlojmë e as ta zbusim. Mungesa e informacioneve shtesë që është pikërisht nga ekzekutivi, që do t'i sugjeroja nënkryetarit ta pranonte si kritikë shumë konstruktive, në mënyrë që në të ardhmen mos të jenë në lajthitje këshilltarët komunal, duhet sqarimet të jenë në këto informacione, sepse mungojnë këto gjëra. Në këtë lloj informate do duhej të dimë se kah janë tendencat e menaxhimit të financave, a është ndoshta mungesë dhe pse nuk është bërë te rishikimi i buxhetit rebalanci kur do të bëhej gjashtëmujori etj. Tek të hyrat vetanake është një progres, ndërsa sa i përket dinamikës së planifikuar që shpenzimet buxhetore, konsideroj që pikërisht mallrat dhe shërbimet ta kenë një dallim. Për mosrealizimin e projekteve me kohë, është çështja që Zyra e prokurimit nuk po i kryen tenderët me kohë, apo është problemi tek operatori ekonomik, i cili faktikisht është i pandërgjegjshëm. Shpenzimi i buxhetit për këtë nëntëmujor prej 45.55%, nuk është në nivelin e duhur, por së paku ishte dashur të jetë 60% në nëntëmujorin e vitit fiskal. Gjithashtu ku shkruhet për mallra dhe shërbime, nuk jepet cilat janë mallra dhe shërbime, ku kanë shkuar ato, pra këtë e obligon edhe Ligji për menaxhimin e financave publike, që edhe kur të jepet informata, të jetë e zbërthyer në kode dhe nënkode, apo zëra dhe nënzëra buxhetore. Kërkoj që kur të jepet raporti përfundimtar, të jetë më i zbërthyer, kështu që është mirë me qenë gjithçka në nivelin e duhur.

U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për shpenzimet dhe të hyrat për periudhën janar-shtator 2012.

Pyetja e pestë

Për Propozimvendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), arsyetimin për themelimin e këtij këshilli e paraqiti Agim Salihu, shëf i Zyrës ligjore.

Hetem Kupina, në emër të GP të LDK-së, në cilësinë e anëtarit të këtij Kuvendi, në cilësinë e kryetarit të Këshillit lokal për siguri publike, në cilësinë e një njeriut të certifikuar për këtë punë dhe si njohës i mirë i kësaj pune, në emër të partisë që i takoj, pra të LDK-së, dhe në emrin tim personal, i lus kolegët që pa kurrfarë hezitimi ta miratojnë, sepse kjo gjë është e paraparë me ligj.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, tha se për këtë propozimvendim kemi një vërejtje. Përbërja e tanishme e këtij këshilli është më e dobët sesa që ishte në mandatin e kaluar, pasi që nuk ka përfaqësues të partive politike,

ka përfaqësues të OJQ -ve, d.m.th. ka përfaqësues individ, të cilët përbëjnë vetëm një individ. Mendoj se është dashur të jenë të përfaqësuara edhe partitë politike në përbërjen e këtij këshilli, megjithatë e përkrahim formimin e tij.

Shemsi Veseli, në emër të GP i PDK-së, tha se do të ishte më efektive që në këtë përbërje të këtij këshilli të jenë edhe përfaqësuesit e subjekteve politike, sidomos në Komunë, për arsye se pikërisht këta janë përfaqësuesit që marrin informacione nga qytetarët për shumë shqetësime.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, e përkrahu këtë propozimvendim, por, në anën tjetër, të mos përkufizohet numri i anëtarëve të tij. Nëse kjo është ashtu e paraparë me ligj, atëherë nuk na mbetet asgjë tjetër përpos të zhgënjehemi se shumë ligje po sillen nga organet qendrore që nuk po përkojnë me realitetin atje ku zhvillohet jeta nëpër komuna. Të përjashtohen qytetarët e tjerë, e në anën tjetër të përfshihen në këtë Këshill edhe disa kategori për të cilat konsideroj që më së paku ka nevojë për ta, do të jetë edhe një çudi në mesin e shumë çudirave të tjera.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, ngiti shqetësim rreth përbërjes të këtij këshilli, duke thënë se si subjekt politik dhe si qytetarë, në përbërjen e këtij këshilli nuk kemi asnjë përfaqësues, andaj dhe miratimin e këtij propozimvendimi nuk do ta votoj.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se këtë propozimvendim do ta votojë pasi që ka mbështetje ligjore. Të mos përfaqësohen subjektet tjera që kanë përgjegjësi më të madhe për këtë vend, që besoj se iu takon të jenë aty, mendoj se nuk është në rregull, andaj dhe i bashkohem asaj vërejtjes që e bëri kolegu paraprakisht. Megjithatë këtë propozimvendim do ta përkrahim kështu si është, por mbetet vërejtja për herën tjetër të shihet se si të veprohet.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se ajo që vazhdimisht më shqetëson mua gjatë shqyrtimit të çështjeve të kësaj natyre, që prekin ligjet qoftë për Prishtinën, qoftë të kësaj natyre e të tjera, ne fshihemi prapa ligjit dhe shkelim ligjin. Në cilin ligj, në cilën kushtetutë shkruan që mbi 45% e këtij këshilli, që do duhej të konsiderohej jo lojë, por këshill serioz, duhej të ishin ekskluzivisht minoritarë?!

Në rast se e kemi parasysh këtë përbërje kështu, ky këshill praktikisht është inekzistent, nuk ka pse merret, por mua më shqetëson dublifikimi, një nga përfaqësuesit e secilit komunitet etnik të komunës, d.m.th. vjen kryesuesi për komunitete, përfaqësuesi i Zyrës për komunitete dhe kthim, shoqëritë e veçanta dhe një përfaqësues nga OJQ-të, respektivisht mediat lokale, prandaj kjo përbërje është skandaloze.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha Agim Salihu.

Me shumicë votash, dy kundër dhe një abstenim, u miratua vendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS).

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin për lejimin e mjeteve në shumë prej 100.000.00 €, si ndihmë për punëtorët e organeve të administratës, të institucioneve kulturore dhe qendrave për punë sociale të komunës së Prishtinës, kryesuesi hapi diskutimin.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, tha se ky propozimvendim përmes mjeteve të informimit, është keqinterpretuar tek opinioni, se ky vendim është marr ende pa kaluar në këtë Kuvend, prandaj ne tek tash e kemi këtë propozimvendim dhe besoj që pa asnjë hezitim do të përkrahet edhe nga grupet tjera.

Si grup parlamentar e kemi shqyrtuar dhe analizuar, andaj dhe do ta përkrahim për miratim.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, e përshëndeti rikthimin e dhënies së mjeteve, se vërtet vitet e kaluar kemi raste të tilla kur janë dhënë për festa të ndryshme, duke i ditur pagat e ulëta të Komunës, andaj dhe e përshëndesim një veprim të tillë.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, e përkrahi këtë propozimvendim për miratim.

Shefqet Syelejmani, në emër të GP të AAK-së, ceku se nuk merret asnjë vendim paraprakisht pa kaluar në këtë Kuvend, andaj dhe e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, tha se jam deklaruar për Komitetin për Politikë dhe Financa, e në media këtu është bërë një lajthitje, por ajo me rëndësi është se ne jemi para aktit të kryer, që është e vërteta këtu, dhe ne po votojmë një vendim, të cilin thuajse për mëshirë ne të gjithë jemi dakord që t'iu japim ndihmë të gjithëve, por nuk qeveriset kështu me buxhetin dhe mjetet publike.

Unë kam potencuar se këto mjete po të ishin orientuar në politikat zhvillimore rurale, do të mund të ndihmoheshin bujqit tanë relativisht mirë, prandaj është mirë që mos të manipulohet kështu me punëtorët, sepse praktikisht është forma për të siguruar votat e këtyre punëtorëve, është shumë keq të manipulohet kështu me buxhetin e komunës.

E vetëkuptueshme, unë votoj kundër kësaj.

Naim Makolli shprehu mendimin se do të duhej që kësaj shume t'i shtohet edhe një shumë tjetër, ku do të përfitonin edhe familjet që janë në asistencë sociale. Kjo ka mundësi të bëhet edhe në mbledhjen e ardhshme dhe do të ishte mirë, sepse në buxhetin e komunës së Prishtinës nuk participojnë

vetëm punëtorët që punojnë, por participojnë edhe ata me asistencë sociale, sepse edhe ata obligohen me tatime që kërkon Komuna e Prishtinës.

Naime Osmani tha se lejimi i këtyre mjeteve si ndihmë për punëtorët e administratës, të institucioneve të kulturës dhe të qendrave për punë sociale të komunës së Prishtinës për festat e fundvitit, janë të mirëseardhura.

Pyes se punëtorët e mirëmbajtjes nëpër qendrat e mjekësisë familjare, që janë në kuadër të Komunës së Prishtinës në pjesët rurale, e që nuk janë të privatizuar, punëtorët e mirëmbajtjes nëpër shkollat fillore dhe të mesme dhe shtëpiakët e shkollave, a do të përfshihen në këto lista.

Xhelil Bekteshi tha se në këtë kategori nuk përfshihen institucionet shëndetësore dhe arsimore, d.m.th. përfshihet vetëm stafi administrativ me Drejtorinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë, por përfshihen edhe zjarrfikësit, kurse të tjerët jo.

Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për lejimin e mjeteve në shumë prej 100.000,00 €, si ndihmë për punëtorët e organeve të administratës, të institucioneve kulturore dhe të qendrave për punë sociale të komunës së Prishtinës.

Pika e tetë dhe e nëntë

Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme

Rrahman Ismajli, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

- A po kryhen projektet sipas tenderimit?
- Projekti për ndriçimin e rrugës "Tahir Zemaj"?
- A janë vendosur shtyllat e ndriçimit sipas projektit - tenderit?
- A janë vendosur kabllot sipas projektit - tenderit?. Nëse jo, pse dhe kush përfiton nga mos zbatimi i projekteve.

Naime Osmani, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

- A do të ketë hapësirë dhe mundësi për lëshimin e një linje urbane në relacionin Tenezhdoll - Prishtinë (deri te Shkolla Ekonomike), që t'iu krijohet nxënësve të kësaj ane udhëtim më komod dhe më me pak harxhime?

Liridon Restelica

Pyetja është për anëtarët dhe kolegët e mi asamblast, konkretisht për Vjollca Rizanin dhe Shaip Hajrizin, me të cilët jemi bashkërisht aksionar në kuadër të këtij Kuvendi për ndërmarrjen publike "Hortikultura". Ne bashkërisht kemi bërë një intervistim të kandidatëve, të cilët kanë aplikuar për anëtarë të Bordit të kësaj ndërmarrje, ndërsa në bazë të informacioneve që kam, këta dy kolegët e mi i kanë qar emrat e anëtarëve të Bordit, të cilët janë përzgjedh pa i llogaritur dhe pa u llogaritur në numërim pikët të cilat unë i kam vlerësuar. Pikët e mia nuk janë pranuar në arkiv dhe arsyet nuk i di.

Për mosprezencën time në kohën e poentimit kam një arsye të plotë, për shkak se kam qenë në udhëtim jashtë vendit, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe nuk është marrë parasysh poentimi im.

Si dëshmi për këtë, paraqiti zarfin me formularët origjinal për vlerësimin e kandidatëve për pozitën e drejtorit të Bordit NPK "Hortikultura".

I menjëhershëm ishte reagimi i Vjollca Rizanit, e cila tha se më vjen shumë keq t'i them Liridonit se nuk është e vërtetë që ka udhëtuar jashtë vendit, por ka qenë në Prishtinë. E kemi caktuar orën kur është dashur me i dorëzuar vlerësimin me pikë dhe ky nuk iu është përgjigjur asaj çka e ka thënë vet.

E kemi pritur unë dhe kolegu Shaipi disa herë, duke menduar se është më i angazhuar se ne të dytë, edhe ky vazhdimisht i ka ikur. Krejt problemi kolegë të nderuar është se ky ka pasur për cak me bërë një shok të vetin anëtarë të Bordit mbikëqyrës, edhe për të cilën punë unë dhe kolegu Shaipi nuk jemi pajtuar, sepse ka qenë kandidati më i dobët prej 32 kandidatëve që kanë konkurruar.

Kjo është e vërteta kolegë të nderuar, dhe ne pastaj kemi vazhduar, i kemi proceduar, i kemi marr vlerësimet e Shaipit dhe të mijat, dhe në bazë të këtyre vlerësimeve i kemi zgjedhur katër kandidatë, të cilët kanë qenë me numrin më të madh të pikëve vlerësuese dhe e kemi kryer punën. Nuk mund të pritët pafundësisht dikush që e neglizhon punën.

Liridon Restelica

Ato që i tha Vjollca nuk qëndrojnë. Është e vërtetë ajo që unë që kam qenë në mbledhje të Bordit për shkak të dorëheqjes së kryeshefit ekzekutiv të "Hekurudhës" ka qenë e papritur, pra ka qenë e vërtetë.

Ajo se unë kam qenë në udhëtim zyrtar, është shumë e vërtetë, se ekzistojnë procesverbalet, ekzistojnë vulat në pasaportë kur unë kam dal dhe kam hyrë në Kosovë.

Pyetja ime është në bazë të ligjit, aty nuk shkruan se sa ditë duhet pritur për shpalljen e vlerësimit për anëtarë të Bordit.

Pra, pyetja është: *Pse nuk është marr për bazë poentimi im?*

Sadri Ramabaja, për Drejtorinë e Arsimit.

Kërkojmë nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit që të na raportojë se sa arsimtar janë pranuar duke shkelur institucionin e konkursit në këtë fillim të vitit shkollor, duke filluar nga gjimnazi "Sami Frashëri", ku është relativisht e ndjeshme kjo evidencë, e deri te shkollat më të skajshme, në Dabishec ta zëmë etj. Pres një përgjigje në seancën e ardhshme.

Besa Halimi - Zagragja, u shpreh e pakënaqur për mos marrjen e përgjigjes në pyetjen që e kam shtruar herën e kaluar.

Po e bëjë një pyetje, sepse çdo ditë kur shkoj në punë ose është kamioni i mbeturinave duke i mbledhur mbeturinat, që po e rëndon komunikacionin, ose në raste festive, ose në rastin e ardhjes të ndonjë mysafiri qiten flamujt në orën tetë apo pesëmbëdhjetë në tetë, kur ne shkojmë në punë. Është mirë të përmirësohet kjo, të mos bëhet në këtë kohë, kjo duhet të bëhet më herët apo më vonë, por jo në kohën kur njerëzit shkojnë në punë. Nuk do të duhej vënë flamuj në kohën kur

shkojmë në punë, sa për t'u dukur se po bëhet diçka, ose të pastrohen rrugët në kohën kur po e pengojnë lëvizjen.

Milazim Vitija ngriti shqetësim rreth regjistrimit të nxënësve dhe studentëve të komunës së Prishtinës nëpër shkolla të mesme të komunës së Prishtinës dhe në fakultete.

Shprehu mendimin se po bëhet një padrejtësi ndaj nxënësve të komunës së Prishtinës, sepse vijnë nxënësit nga komunat tjera, ndërsa nxënësit e komunës së Prishtinës mbesin pa u regjistruar nëpër shkollat që janë në territorin e kësaj komune.

Si shembull mund ta marrim shkollën e mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli", ku vetëm 20% të nxënësve janë banorë të komunës së Prishtinës. Prandaj, i kisha bërë pyetje drejtorit të Drejtorisë së Arsimit se a është kjo e vërtet.

Pyetja tjetër që desha ta bëjë, nëse nuk prish punë, meqë drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike nuk qenka këtu, vazhdimisht është duke investuar në fshatrat e komunës së Prishtinës rreth ndriçimit të rrugëve, mirëpo fshatrat, sidomos fshatrat në zonat e thella malore ku rrjeti është shumë i vjetruar dhe në kohën më të madhe, do të thotë sidomos gjatë dimrit dhe tash gjatë vjeshtës kur ka filluar të bie shi, nuk kanë energji elektrike. Prandaj, mendoj se duhet bërë diçka edhe për ato fshatra që së paku ai rrjet të përforcohet me shtylla të reja, apo diç tjetër, sepse vazhdimisht pyesin banorët e asaj pjese se pse ne më së shumti i nënshtrohemi reduktimit të rrymës.

Shemsi Veseli theksoi se përgjigja që më është kthyer nga Drejtoria e Shërbimeve Publike nuk më ka pëlqyer, pasi që vërtetë është një shqetësim jashtëzakonisht i madh i një familje që, kontejnerët janë aty te restorant "Fjala", mbrapa, faktikisht një familje që e ka blerë një shtëpi dhe vazhdimisht janë duke ia gjuajtur bërllokun te dritarja, dhe normalisht që kërkon një zgjidhje.

Nga drejtoria përkatëse, mua më është kthyer përgjigja se *"së bashku me inspektorët e ambientit, pas gjendjes së krijuar në vendin e cekur më lart, kanë caktuar vendin dhe kanë bërë vendosjen e kontejnerëve. Realisht kjo nuk ka ndodhur. Gjendja faktike është se kontejnerët janë në të njëjtin vend, andaj është mirë që të zhvendosen këto dhe mos të kthejnë përgjigje të tilla të pasakta. Nëse i njëjti person e rikthen gjendjen faktike, atëherë për çka janë institucionet, atëherë më mirë mos të quhet drejtori, nëse nuk e kanë guximin, prapë janë policia që asistojnë. Prandaj, nuk është mirë që të luhet me ndjenjat e qytetarëve, aq më shumë edhe me shqetësimin e tyre, siç është rasti në fjalë.*

Unë kërkoj që të merren masat urgjente, që Drejtoria e Inspektionit dhe ajo e Shërbimeve Publike t'i largojnë kontejnerët në vendin e duhur, sepse kundërmimi i aromës mund të shkaktojë edhe sëmundje dhe shumë probleme tjera.

Shefqet Sylejmani ngriti shqetësim rreth këtyre pikave të rendit të ditës, duke cekur se duhet të merremi vesh ose t'i heqim krejt këto pika, ose t'i qesim në fillim. Pra, të mos bëjmë lojë me vetveten tonë. Do të doja të merret një qëndrim dhe me atë qëndrim të njoftohemi në mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa.

Çështja tjetër që duhet veçuar si çështje shqetësuese, të cilën e potencoi edhe z. Milazim Vitija, është shqetësim për të cilin edhe unë shqetësohem, ngase tash e kam këtë informatë dhe i bashkëngjitem kërkesës së tij, që të njoftohemi se a është e vërtet apo jo.

Nuk është në rregull që 20% e kësaj popullate me mbetur jashtë bankave shkollore, e me ardhur me e zënë vendin prej të gjitha komunave tjera, nuk është në rregull ajo nëse është ashtu. Ne kërkojmë të informohemi se është apo nuk është ashtu. Me përgjigjet që më janë dhënë nuk jam i kënaqur aspak. Në njërin prej kërkesave që kam bërë në mbledhjen e kaluar për udhëkryqin të Ministria e Shëndetësisë, gjegjësisht të ish-Tjegullorja ose rruga "Prizreni", unë nuk kam kërkuar vendkalim se nuk rrezikohen aty vetëm udhëtarët, fëmijë, qytetarët, aty ka edhe ndeshje të automjeteve, pra kam kërkuar semafor e jo mbikalim apo nënkalm. Në mungesë të drejtorit të Drejtorisë së Inspektionit dhe të drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pyetjet dhe kërkesat do t'i shtroj me shkrim. Një kërkesë tjetër është edhe ajo e Shoqatës për kthimin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta. Është ky një asociacion i Shoqatës, e cila vepron në Kosovë kaherë, e cila na u ka drejtuar me një kërkesë që ne, si Kuvend i Komunës, ta caktojmë një lokalitet ku do ta vendosnin një bazament, ku do të vendosej busti i heroit tonë kombëtar Hasan Prishtina. Meqenëse datat janë bukur të përafërta me kërkesën e tyre, kërkesa e tyre është me ca data historike, unë po e shtroj këtë çështje në këtë Kuvend dhe pres përgjigje.

Halim Halimi dha sqarime të nevojshme rreth disa vërejtjeve dhe shqetësimeve që u paraqitën nga parafolësit.

Mejreme Berisha tha se në prag kemi 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, ku më 25 nëntor manifestimi do të fillojë në Shkup dhe do të përfundoj më 28 nëntor në Tiranë.

Mua më intereson të di një fakt tjetër, se a ka mundësi Komuna jonë për këtë festë gjithëkombëtare, së paku për ne këshilltarët komunalë, së paku një ditë të shkojmë deri në Vlorë, një autobus njerëz jemi, dhe nuk do të krijoheshin shumë shpenzime.

Dhe, e dyta rreth organizimeve që i ka bërë komuna jonë për këtë festë madhështore.

Pyetja e dytë është përsëri për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit. Dua të di se pse u vonua kaq shumë zgjedhja e drejtorëve në komunën tonë.

Edhe një tjetër pyetje, se disa herë kam kërkuar përgjigje nga drejtoria përkatëse për rrugën "Dëshmorët e Marecit", që del në rrugën "Isa Kastrati". Ju lutem të vijë komisioni që atë rrugë ta bëjë njëkahore, sepse nuk ka ditë që nuk ka ndeshje në ato kthesa.

Hetem Kupina, pyetje për Drejtorinë e Financave dhe Pronës

Më se 150 herë, drejtorin e Drejtorisë e kam lutur gojarisht dhe 24 herë me shkrim, që të gjejë vullnet dhe forcë, të lirohesh, ta them me keqardhje, nga fenomeni injorancë, pa përgjegjësi dhe neglizhencë, pra të lirohesh nga këto tri fenomene.

Më pate premtuar se do ta gjejmë një lokacion dhe do ta qes për shqyrtim në mbledhje të Këshillit të Drejtorëve, por as kjo nuk ndodhi. Për këtë e ndjeva veten shumë të injoruar, por i ke injoruar edhe 8731 qytetarë të Bardhoshit.

Për arsyetim të kësaj krejt çka e thash le të më dëgjojë edhe drejtori dhe ju të nderuar. Ky Kuvend e ka caktuar një vend buzë magjistrales Prishtinë – Podujevë, më konkretisht ngjitur me të ashtuquajturin Treg i kombinuar. Ne nuk e kemi parë të arsyeshme me bërë varreza buzë rrugës kryesore, por e kemi gjetur një vend të shkretë, një vend ku vetëm gjarpërinj dhe zhapinj ka atje. Drejtori nuk gjen forcë, nuk ka gatishmëri, ju ka premtuar qytetarëve, më ka premtuar edhe mua, prapë po të lus, gjej forcë edhe na e cakto një vend sa më shpejt.

Pyetja e dytë. Në fshatrat: Trudë, Milevc, Bërnice e Lartë, Sinidoll, Bërnice e Ulët dhe Bardhosh janë 173 uzurpime, por ju duhet të dilni në terren, ekipi i juajdhe ta vërtetoni një gjë të tillë.

Krejt këto që i bëra, i bëra në emër të qytetarëve të Bashkësisë lokale të Bardhoshit. **Xhelil Bekteshi** tha se pa u hartuar plani urbanistik, ne nuk mund të marrim asnjë vendim. Janë disa rregulla që përcillen dhe analizohen, se nuk është edhe e imja që me thënë vetëm ta marr një vendim, se unë asnjë propozim nuk e marr pa u bazuar në planin urbanistik.

Sa i përket uzurpimeve, disa të dhëna janë, por më vjen keq që janë aty edhe nga pjesa që ju i njihni më mirë, por unë së bashku me inspektionin, do t'i marrim të gjitha masat e duhura.

Tefik Mehmeti tha se dua të dijë se për këtë 100-vjetor a ka organizuar Komuna diçka.

Unë konkretisht e kam një ide, një propozim, një mendim. Meqenëse e kam fatin që jetoj në rrugën "Ismail Qemali", kështu që çka mundemi me bërë ne në atë rrugë nëse nuk mundemi diku tjetër, bile është mirë që në mënyrë simbolike të bëjmë diçka, ta shënojmë edhe ne këtë përvjetor. Është rregulluar një rrugë më poshtë, rr. "24 Maji", por rruga "Ismail Qemali" nuk është prekur edhe është në gjendje të rëndë. Në atë rrugë janë diku përmbi 10 ambasada dhe konsullata në lagjen "Arbëria", ku janë ambasadat turke, gjermania është pak më lartë, ajo franceze, greke, bullgare, USAID-i krejt etj. dhe kjo rrugë është në gjendje shumë të rëndë. Do të ishte mirë që me bërë një organizim në mënyrë simbolike, se e di që tash është vonë, ashtu më tha drejtori, por për vitin e ardhshëm bile me hy si prioritet meremetimi apo rregullimi i saj.

Astrit Hasani, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale

Çka ka ndodhur me projektin e Dodonës, pse nuk është zgjeruar rruga aty te Shtëpia e sporteve?

Naim Makolli ngriti një shqetësim, duke thënë se që prej fillimit të mandatit e deri më sot, kam bërë disa herë pyetje për drejtorin e Infrastrukturës Lokale dhe me keqardhje e them se ende asnjëherë nuk kam marr përgjigje konkrete.

Unë po i përmendi disa, për të cilat nuk kam marr përgjigje konkrete, por edhe kur kam marr përgjigje konkrete, ose më është ndërruar emri, por gjithnjë kam përgjigje të kundërt prej asaj që kam pyetur. Kam pyetur se kur do të bëhet

pranimi i rrugëve “Tutini” dhe rrugës “Aziz Zhilivoda”, kur do të pranohet zyrtarisht si rrugë e kryer apo e pa kryer dhe nuk kam marr përgjigje. Pastaj kam pyetur për rrugën Viti – Bullaj, më është dhënë përgjigja për një rrugë Flotacion – Krilevë, që bien poshtë atje, unë e di mirë, por Drejtoria nuk e di se a e din atë rrugë! Pse më ka dhënë atë përgjigje?

Herën e kaluar kam pyetur për rrugën, për trekëndëshin, për disa rrugica në mes trekëndëshit “Vëllezërit Fazliu”, rrugën që të çon te ish-Deponia edhe përkufizohet me Sinidoll, prapë nuk është përgjigja e saktë. Përgjigjet që jepen nganjëherë janë edhe të pa qarta, ku thuhet “kemi disa rrugica private”, unë nuk e di se cila rrugë quhet private, nëse përmes asaj rruge qarkullojnë 20-30 shtëpi e më tepër. Pastaj përgjigje gjysmake janë kur thotë se janë dy rrugë. Pse nuk ceket me emër se cilat rrugë në atë pjesë janë, hyn në plan për ndërtim këtë vit, andaj e them sinqerisht se nga kjo drejtori asnjëherë nuk kam marr përgjigje konkrete. Besoj që, pavarësisht kush jemi, çka jemi, vet pozita e këshilltarit komunal të obligon që me na dhënë një përgjigje dhe një sqarim më të mirë kur kemi pyetje për drejtorinë e tuaj.

Mbledhja mbaroi në orën 13:45.

**Procesmbajtësi
Zijadin Gashi**

**Zv. Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete
Engin Beyoglu**